




26/02/2025

Krujë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Armed”

Krujë

Finalizohet operacioni policor i koduar “Armed”.

Qarkullonte me armë zjarri pistoletë dhe lëndë narkotike kanabis, në një automjet, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 22-vjeçari.

Vihet në pranga dhe drejtuesi i automjetit, për moskallëzim krimi.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë, municion luftarak, sasia e lëndës narkotike dhe automjeti.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë, në vijim të kontrolleve për kapjen e shtetasve në kërkim, të atyre që qarkullojnë me armë apo lëndë narkotike, mbi bazën e informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Armed”.

Gjatë operacionit, në Fushë Krujë, shërbimet e Policisë kanë ndaluar automjetin me drejtues shtetasin A. V dhe pasagjer shtetasin A. D. Gjatë kontrollit fizik, shtetasit A. D. iu gjetën 1 armë zjarri pistoletë, municion luftarak dhe një sasi lënde e dyshuar narkotike cannabis sativa.

Në përfundim të veprimeve procedurale u arrestuan në flagrancë shtetasit:

A. D., 22 vjeç, banues në Krujë, për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”;

A. V., 27 vjeç, banues në Krujë, për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)